



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

KONKURS

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve hap konkurs për ekspertë me marrëveshje për shërbime të veçanta në pozitat si ne vijim:

1. Ekspert të sigurimit të cilësisë në Institucionet e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (IAAP)
2. Ekspert për trajnim të ofruesve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP)
3. Ekspert për trajnim të ekipeve vlerësuese në procesin e akreditimit të institucioneve për zbatimin e NjMP-së
4. Ekspert për hartimin e rregullores së brendshme për aplikim në proceset e AKK

Kandidatët për pozitën ekspert të sigurimit të cilësisë të IAAP duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë kualifikim të arsimit të lartë;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në arsim, menaxhim apo të ngjashme;
- Të kenë përfunduar trajnime për vlerësim, zhvillim të kurrikulit, zhvillim të programeve;
- Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë përkatëse,
- Shqyrtojnë aplikacionet dhe gjithë dokumentacion e ofruesve të AAP për akreditim të institucioneve,
- Realizojnë vizita në terren,
- Bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të panelit, diskutojnë dhe harmonizojnë qëndrimet e tyre,
- Kontribuojnë në përgatitjen e një raporti që përcakton të gjeturat (gjetjet) dhe rekomandimet në lidhje me akreditimin e institucioneve,
- I raportojnë Drejtorit të AKK.

Kandidatët për pozitën ekspert për trajnim të ofruesvë që zbatojne NjMP dhe ekspert per trajnim të ekipeve vlerësuese për NjMP duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë kualifikim të arsimit të lartë;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në arsim, trajnim, menaxhim apo të ngjashme;
- Të kenë njohuri në proceset e NjMP;
- Të kenë përfunduar trajnime për vlerësim, zhvillim të kurrikulit, zhvillim të programeve;
- Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë përkatëse;
- Bashkëpunojnë me personelin e AKK;
- Hartojnë dhe prezantojnë materialet për trajnim;
- Zhvillojnë seanca trajnimi;
- Hartojnë raporte pune.

Kandidatët për pozitën ekspert për hartimin e rregullores së brendshme për aplikim në proceset e AKK duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë kualifikim të arsimit të lartë;
- Të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në administratë publike, menaxhim apo të ngjashme;
- Të kenë njohur rreth procesit te akreditimit dhe validimit;
- Të kenë njohuri të teknologjisë informative.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ekspertët e përzgjedhur do të nënshkruajnë kontratë përkatëse;
- Shqyrtojnë dokumentet egzistuese të AKK, si dhe dokumentet tjera ligjore në fuqi;
- Mbështesin dhe ndihmojnë AKK në harmonizimin (hartimin e draftit final) të rregullores së brendshme me dokumentët tjera dhe legjislacionin në fuqi për aplikim në proceset e AKK;
- Bashkëpunojnë me personelin e AKK;
- Hartojnë raporte pune.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kushtet, ti paraqesin dokumentet si në vijim:

- CV në formatin europass;
- Diplomat dhe certifikatat;
- Referencat

Dokumentet që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e lartëcekura nuk do të shqyrtohen.

Aplikimi bëhet vetëm në formë elektronike në këtë adresë donjeta.n.gashi@rks-gov.net.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve,

Rr. Agim Ramadani p.n, Qendra e Studentëve , Prishtinë.

Tel: 038- 212 595

Afati i aplikimit: Nga data 12.06.2020 deri më 25.06.2020.

Për më shumë klikoni: www.akkks.rks-gov.net